

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Erste Asset Management GmbH, me adresë afariste në Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri, përmes përfaqësuesit të autorizuar Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 30.01.2025, e solli këtë

### **AKTVENDIM**

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Erste Asset Management GmbH, me adresë afariste në Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri do të fitojë kontroll mbi INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o., me seli në rrugën Masarykova nr. 1, Zagreb, Kroaci, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

### **A R S Y E T I M**

Sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 25.12.2024 dhe e plotësuar më 30.12.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Erste Asset Management GmbH, me adresë afariste në Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri, me të cilin Erste Asset Management GmbH do të fitojë kontroll mbi INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o., me seli në rrugën Masarykova nr. 1, Zagreb, Kroaci.

Para Transaksionit, INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o. është kontrolluar nga **INTERKAPITAL d.d.**, me seli të regjistruar në adresën Masarykova nr. 1, Zagreb, Kroaci. Pas përfundimit të Transaksionit, Erste Asset Management GmbH do të fitojë pronësi mbi INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o. Para kompletimit të Marrëveshjes për shitblerjen e pjesëmarrjes, INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o. do të kalojë një sërë ristrukturimesh korporative. Konkretisht, **INTERKAPITAL d.d.** është aksionari i vetëm i INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o., duke zotëruar katër aksione që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar. Para përfundimit, INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o. do të kalojë një proces korporativ ndarjeje me themelim (podjela s osnivanjem), sipas të cilit mjete dhe detyrime të caktuara të INTERKAPITAL ASSET

MANAGEMENT d.o.o. do të transferohen tek tre subjekte të ndërlidhura të kontrolluara nga **INTERKAPITAL d.d.** Mjetet e ndara (ang. Carved-out Assets) do të përjashtohen nga transaksioni i rregulluar me Marrëveshjen e shitblerjes, duke kufizuar fushëveprimin e saj në **Mjetet që nuk ndahen** (ang. **non-carved-out Assets**).

Mjetet që nuk ndahen (ang. **non-carved-out Assets**) të cilat do të jenë objekt i Transaksionit përfshijnë fondet e mëposhtme:

| Emri                                                                              | Lloji                                                                                                                                                       |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| InterCapital Balanced                                                             |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Bond                                                                 |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Dollar Balanced                                                      |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Global Equity                                                        |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Global Technology                                                    | Ndërmarrje për Investim Kolektiv në Letrat me Vlerë të Transferueshme (ang. UCITS) (ang. Undertakings for Collective Investment in Transferable Securities) |
| InterCapital Income Plus                                                          |                                                                                                                                                             |
| InterCapital SEE Equity                                                           |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Short Term Bond                                                      |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Short Term Dollar Bond                                               |                                                                                                                                                             |
| InterCapital UCITS krovnii otvoreni investicijski fond s javnom ponudom           |                                                                                                                                                             |
| InterCapital Nova Europa otvoreni investicijski fond s javnom ponudom             |                                                                                                                                                             |
| Fond hrvatskih branitelja iz Domovinskog rata i članova njihovih obitelji         | Fond specifik (ang. Specific fund)                                                                                                                          |
| ICAM Total Return                                                                 |                                                                                                                                                             |
| INTERCAPITAL Commodity Strategy fond alternativ i hapur investim s javnom ponudom | Fond alternativ investimi (ang. Alternative investment fund)                                                                                                |

Pas përfundimit të ndarjes (ang. Carve-out), kapitali aksionar i INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o. do të reduktohet, ndërsa **INTERKAPITAL d.d.** do të ketë pjesëmarrjen e vetme në INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o., që përfaqëson 100% të kapitalit të tij aksionar pas ndarjes.

Pas kësaj, Erste Asset Management GmbH do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi INTERKAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o., në kuptim të nenit 12, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për koncentrim, plotësimeve dhe anekseve, konstatoi si vijon:

## **Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

**Erste Asset Management GmbH** është me veprimtari themelore të cilat përbëhen nga veprimtari për menaxhim të mjeteve dhe është pjesë e grupit të kompanive **Erste** (“Grupi Erste”), një nga ofruesit më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore, i cili ofron shërbime bankare për persona fizikë dhe juridikë, si dhe shërbime financiare. Funksionimi i Grupit Erste është i ndarë në banka për individë, banka komercial, tregje të grupit, menaxhim aktiv dhe pasiv dhe qendër lokale për transaksione komerciale, bankë besueshmërie, si dhe qendër për transaksione komerciale në nivel të grupit. Megjithatë, veprimtaria primare e Grupit Erste është ofrimi i shërbimeve bankare për persona fizikë dhe juridikë.

Vetë Erste Asset Management GmbH nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Grupi Erste është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes personave juridikë të lidhur dhe gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut:

1. Shparkase Banka AD Shkup, me seli në Vasil Iljoski 14, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria themelore e të cilës është ndërmjetësim tjetër monetar.
2. Shparkase Leasing DOO Shkup me seli në rr. Maqedonia 34, Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria themelore e të cilës është lizing financiar.
3. S-AMC1 DOOEL Shkup – në likuidim, me seli në Vasil Iljoski 14, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria themelore e të cilës është blerja dhe shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të vet.

**INTERCAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, është me veprimtari themelore të cilat përbëhen nga themelimi dhe menaxhimi i fondeve alternative të investimit.

INTERCAPITAL ASSET MANAGEMENT d.o.o, nuk është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës

efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**